



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Këshilli Drejtues

V E N D I M

Nr.2695, datë 27.10. 2016

Për miratimin e dokumentit Rregullore “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Sara Reçi, në mbledhjen e datës 27.10.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimi i dokumentit Rregullore “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

BAZA LIGJORE:

1. Ligj nr. 44/2015 datë 30.4.2015 “Kodi i procedurave administrative” (**K.Pr.A**);
2. Ligji nr.9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**) Neni 8 gërma f), neni 110, neni 133, neni 134, neni 135;
3. Urdhëri Nr.1795 datë 8.06.2016 për “Hartimin e akteve normative administrative: 1.“Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, 2.“Rregullore për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
4. Vendimi i Keshillit Drejtues te AKEP Nr.2686, datë 31.08.2016, për miratimin e dokumentit për këshillim publik Rregullore “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Relacionin shpjegues mbi çështjen në shqyrtim dhe aktin e propozuar për miratim
- Dokumenti Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
- Dokumenti “Komentet e pjesëmarrësve dhe qendrimi i AKEP në këshillimin publik mbi Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
- Projekt Vendimi i formatuar dhe arsyetuar;

Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se:

Dokumentin Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, është hartuar me qëllim, rregullimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike, të fushës, ku ushtrohet veprimtaria, të parashikuara në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008 dhe përshtatjen e rregullave të inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike me drejtimet e përgjithshme të zhvillimit dhe kryerjes së inspektimit sipas Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit, miratuar me Urdhër nr.13, datë 23/04/2015 për "Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë" të Inspektorit të Përgjithshëm dhe legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

Janë respektuar afatet dhe procedurat e këshillimit publik të përcaktuara në VKD Nr.2686 datë 31.08.2016 për miratimin e dokumentit për këshillim publik.

Në përputhje me afatet e përcaktuara janë administruar nga Grupi i Punës komentet nga sipërmarrësit në cilësinë e palëve të interesuara si më poshtë:

- Vodafone Albania sh.a shkresa datë 07.10.2016 Nr. LRD/0111/1K (AKEP nr. prot 1486/2 datë 10.10.2016) me objekt “Komente te Vodafone Albania sh.a në lidhje me këshillimin publik të dokumentit Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”
- Telekom Albania sh.a shkresa datë 06.10.2016 me nr.6220 prot (AKEP nr.1486/3 prot datë 12.10.2016) me objekt “Komente të Telekom Albania sh.a në lidhje me këshillimin publik të dokumentit Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”
- Plus Communication sh.a shkresa datë 07.10.2016 nr.1145 prot (AKEP nr.1486/1 prot. datë 10.10.2016) me objekt Komente dhe propozime të Plus Communications sh.a në lidhje me këshillimin publik të dokumentit Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”
- Albtelecom sh.a me e-mail datë 12.10.2016.

Dokumenti “Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP” në këshillimin publik të dokumentit Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” paraqet komentet e të gjithë sipërmarrësve (palëve të interesuara) për të gjitha çështjet e ngritura dhe qëndrimin e AKEP për secilën çështje përkatësisht.

Dokumenti Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” i propozuar nga grupi i punës është i drejtë, i bazuar ligjërisht dhe në përputhje me synimet dhe funksionet e AKEP për përmbushjen e objektivave rregullatore të përcaktuara në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008.

Praktika dokumentare për shqyrtim të çështjes sipas objektit është paraqitur nga Grupi i punës në përputhje me kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 12 të Rregullores së Brendshme të AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Pasi e gjen dokumentin në përputhje me kërkesat ligjore në mbështetje të nenit 114 dhe nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe bazës ligjore sipercituar,

V E N D O S:

1. Të miratojë dokumentin Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”,”
2. Ky Vendim dhe dokumenti Rregullorë “Metodika e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”” të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al,
3. Komentet e palëve të interesuara në Këshillim Publik të publikohen në faqen e internetit të AKEP www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Anila DENAJ** _____
3. **Ketrin TOPÇIU** _____
4. **Klarina ALLUSHI** _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr.46, datë 27.10.2016

“METODIKA

E

**INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË SË
SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE
SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE”**



www.akep.al

e-inspektim

Miraturar me Vendim të Këshillit Drejtues nr 2695 datë 27.10.2016

PERMBAJTJA

KAPITULLI I - TË PËRGJITHSHME

1.1 Qellimi i inspektimit	4
1.2 Perkufizime dhe shkurtime	4
1.3 Qellimi i rregullores Metodika e Inespektimit.....	4
1.4 Objekti	5
1.5 Parimet e Inspektimit	5
1.6 Llojet e Inspekimit	5
1.6.1 Inspektimi i programuar.....	6
1.6.2 Inspektimi rastesor	6
1.6.3 Inspektimi në rastet e aksidenteve	6
1.7 Organizimi i sistemit te inspektimit ne AKEP.....	6
1.8. Roli dhe përgjegjësitë e sistemit së inspektimit.....	6
1.8.1.Roli dhe përgjegjësitë e drejtorisë së monitorimit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit	6
1.8.2 Inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimeve	7
1.8.3 Inspektorët dhe stafi mbështetëse	8
1.8.4 Pavorsia dhe objektiviteti i inspektorit.....	8
1.9 Karta e inspektorit.....	8

KAPITULLI II - PROGRAMIMI I VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT

2.1. Planifikimi i inspektimit	9
2.2 Metodika e planifikimit të inspektimit.....	9
2.3 Planifikimi i inspektimit mbi bazën e riskut	10
2.3.1 Vlerësimi i riskut gjatë Planifikimit Strategjik dhe vjetor të inspektimit	10
2.3.2 Vlerësimi i riskut gjatë inspektimit.....	11
2.4 Plani vjetor i inspektimit.....	11
2.5 Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor.....	12
2.6 Planifikimi mujor i inspektimit.....	12
2.7 Planifikimi javor i inspektimit	13
2.8 Grupi i inspektimit	13
2.9 Ndarja e detyrave brenda anëtarëve të grupit të inspektimit.....	13
2.10 Kohëzgjatja (afatet kohore) dhe masat për sigurimin e cilësisë	13

KAPITULLI III - RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË AUTORIZIMIT DHE PROCESIT TË INSPEKTIMIT

3.1	Procedura e inspektimit.....	14
3.1.1	Gjenerimi i Autorizimit dhe njoftimi i tij te subjekti i inspektimit	14
3.1.2	Veprimet e grupit të inspektimit	15
3.1.3	Pranimi i inspektorëve dhe përgjegjësitë e subjektit të inspektimit	15
3.1.4	Kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve	16
3.2	Procesi i gjetjeve të inspektimit	16
3.3	Bllokimi i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre	17
3.4	Procesverbali i inspektimit.....	17
3.5	Masat urgjente.....	18
3.5.1	Vendimi i ndërmjetëm	18
3.6	Ankimi i veçantë	19
3.7	Procesverbal inspektimi (I posaçëm)	19
3.8	Vendimi përfundimtar.....	19
3.9	Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit.....	20
3.10	Vendimmarrja e Këshillit Drejtues	20
3.11	Ekzekutimi i vendimit përfundimtar	21
3.12	Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi.....	21
3.13	Raportimi i ndjekjes së detyrave të lëna	22
3.14	Kriteret për vendosjen e Masave administrative.....	22

KAPITULLI IV - RAPORTIMI DHE KOMUNIKIMI I INSPEKTIMIT

4.1	Komunikimi i inspektimit.....	23
4.2	Struktura e raporteve të inspektimit.....	23
4.3	Raportet periodike dhe raporti vjetor i inspektimit.....	24
	DISPOZITA TE FUNDIT	24
	ANEKS A	25

RREGULLORE

METODIKA E INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË SË SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

Në mbështetje të shkronjave a) dhe p) të nenit 8, neneve 132, 134, e nw vijim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit,

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

VENDOSI:

KAPITULLI I TË PËRGJITHSHME

1.1 Qëllimi i inspektimit

AKEP ushtron veprimtarinë inspektuese me qëllim mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, për vlerësimin e përpuethshmërisë së saj me përcaktimet e parashikuara me ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligj nr. 9918/2008*), aktet e tjera në zbatim të tij, kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhe autorizimet individuale.

1.2 Pwrkufizime dhe shkurtime

AKEP – Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

QKMF – Qendra Kombetare e Monitorimit te Frekuencave

DMFCI – Drejtoria e Monitorimit te Frekeuencave, Cilesise dhe Inspektimit

DZMMK – Drejtoria e Zgjidhjes se Mosmarreshjeve dhe Mbrojtjes se Konsumatorit

MPI – Manuali i Pergjithshem i Inspektimit

1.3 Qëllimi i Rregullores Metodika e Inspektimit

Qëllimi i rregullores metodikës së inspektimit është rregullimi i ushtrimit nga AKEP i veprimtarisë inspektuese sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike të fushës ku ushtrohet veprimtaria, të parashikuara në ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij.

1.4 Objekti

Rregullorja mbi metodikën e veçantë e inspektimit përcakton politikat, standardet dhe procedurat që ndiqen nga AKEP për ushtrimin e veprimtarisë inspektuese në përshtatje me drejtimit e përgjithshme të zhvillimit dhe kryerjes së inspektimit sipas Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit (MPI).

1.5 Parimet e inspektimit

Parimet të cilat udhëheqin ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit nga AKEP janë:

- a) **Pavarësia** : Inspektori apo grupi i inspektimit, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret;
- b) **Proporcionaliteti**: Veprimet e inspektimit kryhen në mënyrë të tillë që ndërhyrja në veprimtarinë e subjektit të inspektimit të jetë vetëm për atë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit dhe me mjetet më të përshtatshme të arrihet qëllimi i synuar;
- c) **Programimi i inspektimit**: Inspektimi i veprimtarisë së sipërmarrësve kryhet sipas një programi me tematika të vlerësuara mbi bazën e analizës së riskut në raport me zbatimin e kushteve të përgjithshme të Autorizimit të Përgjithshëm dhe kushteve specifike sipas autorizimit individual, si dhe nevojën e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, interesit publik dhe në mënyrë veçantë të përdoruesve;
- d) **Informimi i publikut**: AKEP informon sipërmarrësit dhe publikon konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrative të inspektimit në përputhje me përcaktimet ligjore mbi transparencën dhe publikimin e informacionit të parashikuara në ligjin nr. 9918/2008 dhe legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.
- e) **Mbrojtja e konfidencialitetit**: Veprimet e inspektimit dhe publikimi i informacionit kryhet në zbatim të kërkesave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të mbrojtjes së të dhënave që lidhen me sekretin tregtar të sipërmarrësve.
- f) **Parimi i dispozitës më të favorshme**: Inspektori gjatë punës së tij nëse vëren që një sipërmarrës ka zbatuar një ligj i cili është në kundërshtim me një tjetër, atëherë ai është i ligjshëm, si dhe në çdo rast zbaton dispozitën më të favorshme në hierarkinë e ligjeve të barazvlefshëm.

1.6 Llojet e inspektimit

Inspektimi përfshin çdo formë kontrolli që AKEP kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe autorizimeve individuale nga sipërmarrësi subjekt inspektimi.

Inspektimi kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit, si dhe nga zyrat e AKEP për kontrollin e veprimtarisë së monitoruar në distancë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet në fuqi të nxjerra nga AKEP.

Inspektimet për nga forma e autorizimit dhe organizimit të tyre ndahen në:

- a) *Inspektimi i programuar*
- b) *Inspektimi rastësor*
- c) *Inspektimi në rastet e aksidenteve*

1.6.1 Inspektimi i programuar

Inspektimi i programuar është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit nga AKEP. Si rregull i përgjithshëm ligjor çdo sipërmarrës mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përgjithësisht, një inspektim konkretisht mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit në rastet e përcaktuara në ligjin e inspektimit ose kur parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm.

1.6.2 Inspektimi rastësor

Inspektimi rastësor është ajo formë inspektimi, jashtë programi dhe pa autorizim, në të cilën subjekti i inspektimit është i përcaktueshëm në mënyrë rastësore në bazë të veprimtarisë së caktuar që kryen apo në bazë të marrëdhënies me një ngjarje të përcaktuar, përfshirë kalimin rastësor të inspektorit në një periudhë të përcaktuar në një rrugë publike, ku ushtrohet inspektimi apo ushtrimi i veprimtarisë në një zonë gjeografike a një treg të caktuar ku AKEP ushtron veprimtarinë.

1.6.3 Inspektimi në rastet e aksidenteve

Inspektimi në rast të ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve që kanë çënuar apo mund të çënojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin, është inspektim jashtë programi dhe fillon me kërkesën e drejtorit të DMFCI dhe konfirmimin verbal të Titullarit, pa autorizim për shkak të nevojës urgjente për kryerjen e tij. Por autorizimi mund të nxirret brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe pasi inspektimi ka filluar.

1.7 Organizimi i sistemit të inspektimit në AKEP

Sistemi i inspektimit në AKEP përbëhet nga tërësia e strukturave që janë përfshirë dhe kryejnë funksione inspektimi në përbërje të drejtorisë së monitorimit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit (*DMFCI*):

- a) Sektori i Planifikimit dhe Koordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit
- b) Sektorët Rajonalë të Monitorimit dhe Inspektimit.

Sistemi i veprimtarisë së inspektimit është i organizuar në sektorë rajonalë në mënyrë që të mbulojë gjeografikisht aktivitetin e sipërmarrësve në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sektorët rajonalë të inspektimit janë të vendosur në qytetin e Krujës, Shkodrës, Korçës dhe Vlorës.

Sektori i planifikimit dhe koordinimit të monitorimit dhe inspektimit, në përbërje të drejtorisë së monitorimit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit është i vendosur në Qendrën Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave në Tiranë (*QKMF*).

Inspektimi kryhet nga inspektorët e emëruar sipas strukturës dhe organikës së AKEP, me grup inspektimi të mbështetur me ekspertizë sipas rastit dhe tematikës së inspektimit.

1.8 Roli dhe përgjegjësitë e sistemit së inspektimit

1.8.1 *1.7.1 Roli dhe përgjegjësitë e drejtorisë së monitorimit të frekuencave, cilësisë dhe inspektimit:*

Roli i DMFCI është përmirësimi i efektivitetit dhe i përgjegjshmërisë në veprimtarinë e inspektimit nga AKEP në fushën e komunikimeve elektronike.

DMFCI ka përgjegjësi për hartimin e metodikës apo udhëzimeve dhe akteve zbatuese të inspektimit për fushën e komunikimeve elektronike në juridiksionin e AKEP, në zbatim të Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit apo akteve të tjera të nxjerra nga AKEP dhe dërgimi i tyre për miratim tek organi kompetent dhe njohje pranë Inspektoriatit Qendror, si:

- Hartimi i planeve strategjike dhe vjetore për veprimtarinë e inspektimit për fushën e komunikimeve elektronike;
- Kryerja e veprimtarisë së inspektimit në pajtim me udhëzimet dhe metodologjinë e miratuar dhe vlerësimin nëse procedurat e inspektimit dhe performance e inspektorëve, janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë;
- Ndjekja dhe raportimi periodik për zbatimin e politikave dhe programit të inspektimit, që rezultojnë nga veprimtaria inspektuese, si dhe dhënia e informacionit në nivelet administrative dhe institucionale të parashikuara ligjërisht;
- Hartimin e nevojave për trajnimin e inspektorëve me metodologjinë e fundit të inspektimit;
- Përgatitja e raporteve vjetore, ose periodike, të cilat dërgohen në nivelet administrative dhe institucionet e prore të varësisë.

Këto raporte përmbajnë të dhëna lidhur me:

- i) Realizimin e objektivave të inspektimit të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatja e çdo inspektimi dhe nëse ka pasur shmangie nga plani jepen arsyet dhe argumentet përkatës;
- ii) Konkluzionet dhe përfundimet lidhur me funksionimin e sistemit të inspektimit së bashku me rekomandimet për përmirësimet; dhe
- iii) Veprimet e ndërmarra nga me menaxhimi për zbatimin e programit të inspektimit me efikasitet.

1.8.2 Inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimeve

Inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimeve është strukturë në përbërje të sektorit të Planifikimit dhe Koordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit dhe është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e planit mujor dhe ditor të veprimtarisë së inspektimit në AKEP, në nivel qendror dhe rajonal, sipas programit vjetor të miratuar.

Për inspektimet e kryera me grup inspektimi ai kryen detyrën e përgjegjës të grupit të inspektimit dhe mbikëqyr:

- procesin e inspektimit në mënyrë që të sigurohet se inspektorët marrin mbështetjen e nevojshme;
- që burimet e inspektimit të përdoren me dobi dhe kursim; dhe se inspektimi kryhet:
 - i) sipas planit të miratuar dhe Autorizimit të nxjerrë;
 - ii) në përputhje me metodologjinë dhe standardet e përcaktuara;
 - iii) në nivel të përshtatshëm menaxhimi ose procesi të njësisë; dhe
 - iv) Duke diskutuar me inspektorët mbi mënyrat më efikente për procesin e inspektimit.

Nëse sipas gjykimit të inspektorit të Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimit kërkohet që të bëhet një shmangie (*shtyrje e autorizimit, zëvendësim inspektori etj.*) nga Plani i miratuar i inspektimit, kjo duhet të diskutohet me drejtorin e DMFC, dhe të dokumentohet plotësisht dhe të miratohet nga Titullari i AKEP

1.8.3 Inspektorët dhe stafi mbështetës

Inspektorët dhe ekspertët e AKEP në mbështetje të tyre, duhet të kryejnë funksionet dhe detyrat zyrtare në përputhje me ligjin e inspektimit dhe ligjin nr. 9918/2008, si dhe në zbatim të “Kodit të etikës për punonjësit e Inspektoriateve Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, të hartuar nga Inspektoriat Qendror, i cili ka për qëllim rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë, parandalimin e sjelljeve abusive dhe konfliktin e interesit gjatë kryerjes së detyrave nga inspektorët dhe është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë punonjësit e AKEP të angazhuar në procese inspektimi, duke rritur performancën në përputhje me përcaktimet e tij.

Inspektorët dhe ekspertët në mbështetje të tyre duhet të jenë të pavarur gjatë procesit të inspektimit dhe të garantojnë kryerjen e detyrave në përputhje me Standardet ligjore dhe profesionale. Për të siguruar pajtueshmërinë me këto Standarde, inspektorët deklarojnë paraprakisht pavarësinë e tyre duke plotësuar deklaratën për konfliktin e interesit.

1.8.4 Pavarësia dhe objektiviteti i inspektorit

Pavarësia përcaktohet si të qënurit i lirë nga kushtet që kërcënojnë objektivitetin ose të qënurit objektiv. Kërcënimet e objektivitetit duhet të menaxhohen në nivele individuale angazhimi, funksionimi dhe organizative të inspektorit. Objektiviteti përshkruhet si një gjykim i paanshëm që i mundëson inspektorët të kryejnë kontrollet e subjekteve të inspektimit në mënyrë të tillë që të kenë besim përse i përket produktit të punës së tyre dhe se nuk është bërë ndonjë kompromis përse i përket cilësisë. Objektiviteti kërkon që inspektorët, për problemet e inspektimit, të mos varen nga gjykimet e tyre nga të tjerët.

Pavarësia Organizative brenda institucionit është e rëndësishme dhe nënkupton që strukturat e inspektimit në AKEP raportojnë direkt tek eprori i tyre. Strukturat e inspektimit nuk mund të angazhohen në detyra të tjera Brenda AKEP të cilat nuk lidhen me funksionimin e sistemit të inspektimit.

Konsiderohen kërcënime që janë të pranishme ose mund të ndodhin, të cilat mund të kompromentojnë pavarësinë e inspektorëve:

- Kërcënim i interesit vetjak;
- Kërcënim i rishikimit të punës vetjake, ose të miqve të tyre;
- Kërcënim menaxherial;
- Kërcënim familjarizimi;
- Kërcënim mbrojtës;
- Kërcënim nga frika/kanosja.

Drejtori i DMFCI është personi që ka përgjegjësinë për të përcaktuar se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të ruajtur pavarësinë e inspektorit, për të zbutur ose minimizuar riskun e kërcënimit.

1.9 Karta e inspektorit të AKEP

Çdo inspektor i AKEP pajiset me kartën e tij të inspektimit. Karta e inspektimit është pronë e AKEP dhe përbën aktin/dokumentin zyrtar identifikues të inspektorit.

Modeli i dhënë në Aneksin A është modeli i kartës së inspektorit të miratuar nga AKEP. Karta e Inspektorit të AKEP regjistrohet nga Inspektoriat Qendror në Regjistrin Kombëtar të Inspektorëve.

AKEP njofton Inspektoriatin shtetëror për çdo emërim në detyrë të inspektorëve në provë apo lirim nga detyra, jo më vonë se 2(dy) ditë pune nga emërimi ose lirimi i tyre. Inspektoriati Qendror me marrjen e njoftimit nga AKEP për emërimin apo lirimin nga detyra të inspektorit, bën përditësimin e Regjistrit Kombëtar të Inspektorëve.

Çdo inspektor i liruar nga detyra dorëzon në AKEP kartën e inspektorit, në momentin e lirimimit të tij nga Detyra.

KAPITULLI II PROGRAMIMI I VEPRIMTARISË SË INSPEKTIMIT

2.1 Planifikimi i inspektimit

Veprimtaria e inspektimit në AKEP kryhet mbi bazën e programimit sipas tre lloj planesh:

- **Plani Strategjik**, i cili përcakton drejtimit dhe objektivat kryesore të inspektimit në terma afatgjatë disa vjeçarë (zakonisht deri 3 vjet). Plani Strategjik 3 vjeçar propozohet nga DMFCI dhe miratohet nga mbledhja e Këshillit Drejtues, si dhe do të përditësohet çdo vit, me qëllim që të sigurohet përshtatja e tij.
- **Plani vjetor**, bazohet në Planin Strategjik dhe përcakton më në detaje veprimtarinë e inspektimit që do të ndërmerret gjatë vitit ushtrimor nga AKEP në tërë territorin e Republikës së Shqipërisë. Plani vjetor i inspektimit propozohet nga DMFCI pas konsultimit me sektorin e Planifikimit dhe Koordinimit të Monitorimit dhe Inspektimit si dhe sektorët Rajonalë të Monitorimit dhe Inspektimit dhe, miratohet nga Titullari i AKEP.
- **Plani mujor**, i cili del në zbatim të Planit vjetor, propozohet nga inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të Inspektimit në konsultim me inspektorët rajonalë, miratohet nga drejtori i DMFCI dhe konfirmohet nga Titullari i AKEP. Plani mujor i inspektimit duhet të mundësojë mbulimin e problematikës së shfaqur në veprimtarinë e sipërmarrësve si dhe tematikës dhe objektivave të planifikuar vjetor.

Planifikimi ditëor i inspektimit bëhet në funksion të zbatimit të planit mujor të inspektimit. Inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimit në bashkëpunim me inspektorët rajonalë të inspektimit planifikon veprimet ditore duke informuar për zbatimin e tij drejtorin e DMFCI.

2.2 Metodika e planifikimit të inspektimit

Planifikimi i inspektimit bazohet mbi njohjen e thellë të veprimtarisë së fushës ku ushtrojnë aktivitetin sipërmarrësit dhe llojeve të subjekteve të inspektimit. Njohja e veprimtarisë së subjekteve për qëllim inspektimi kërkon marrjen në konsideratë të:

- Rrisqet e përgjithshme me të cilat përballlet fusha e komunikimeve elektronike;
- Kuadrit ligjor dhe rregullator;
- Performancën e mëparshme të zbatimit të kërkesave ligjore të subjekteve të inspektimit (sipërmarrësve) dhe kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm dhe ato të veçanta të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e burimeve të fundme (frekuenca, numeracion).

Të gjitha këto ndihmojnë në përcaktimin e metodës së inspektimit, e cila duhet të jetë:

Efiçente: Burimet për inspektim caktohen sipas çështjeve me risk më të lartë dhe metoda e inspektimit zgjidhet për të përmbushur objektivat e AKEP me kosto sa më të ulët;
Efektive: Sigurimi i të dhënave përkatëse të mjaftueshme në mbështetje të procesit të inspektimit;
Shtues vlerë: Subjektet këshillohen mbi menaxhimin e riskut dhe kontrolleve të brendshëm për zbatimin e kërkesave ligjore sipas kushteve të tyre.

2.3 Planifikimi i inspektimit mbi bazën e riskut

Planifikimi i inspektimit përgatitet mbi bazë risku që nënkupton se inspektimi fokusohet në ato subjekte (sipërmarrës) veprimtaria e të cilëve përmban aspekte me mundësi të ushtrimit në mospërputhje të plotë ose në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kuadrin rregullator. Vlerësimi i riskut kryhet gjatë gjithë procesit të inspektimit, veçanarisht në fazat e planifikimit në nivel Strategjik dhe vjetor, por dhe gjatë procesit të inspektimit.

2.3.1 Vlerësimi i riskut gjatë Planifikimit Strategjik dhe vjetor të inspektimit:

Analiza e riskut mbi të cilën bazohet kryesisht Plani Strategjik dhe ai vjetor i inspektimit, parimisht konsideron faktorët më relevantë me ndikim në treg dhe në mundësinë e konsumimit nga ana e sipërmarrësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së autorizuar, të veprave të parashikuara ligjërish si kundërvajtje administrative dhe/ose në mos përputhje me kushtet e përgjithshme dhe ato specifike sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe Autorizimit Individual për përdorimin e burimeve të fundme, me të cilët janë pajisur nga AKEP, si :

- Pesha në treg e subjektit (sipërmarrësit) nga pikëpamja e rrjetit dhe shërbimeve publike që ofron si dhe peshës në treg referuar numrit të përdoruesve;
- Lloji, larmia dhe teknologjia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit për publikun;
- Standardet teknike, infrastruktura dhe cilësia e rrjeteve dhe shërbimeve që ofrojnë sipërmarrësit;
- Numri i ankesave të pajtimtarëve dhe performanca e sipërmarrësit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtimtarët dhe midis sipërmarrësve;
- Performanca e plotësimi të detyrimeve lidhur me sigurinë kombëtare, sigurinë e rrjeteve, mbrojtjen e të dhënave personale, regjistrimin e të dhënave identifikuese të pajtimtarëve, masave për gjendjet e jashtëzakonshme etj;
- Rezultatet historike të inspektimit;
- Indeksi i reagimit dhe plotësimi i rekomandimeve nga sipërmarrësit të rregullimit të shkeljeve të konstatuara dhe vendosura nga inspektorët dhe/ose AKEP, në aktet e inspektimit;
- Performanca e zbatimit të kushteve të veçanta të përcaktuara në aktet e AKEP për përdorimin e burimeve të fundme.

Vlerësimi i riskut gjatë Planifikimit Strategjik dhe vjetor kryhet duke analizuar në mënyrë të përgjithshëm veprimtarinë e sipërmarrësve të regjistruar në *database* e AKEP, referuar faktorëve ndikues të mësipërcituar. Për arsye metodike të vlerësimit, subjektet e inspektimit kategorizohen sipas nivelit të mundshëm të rrezikut të riskut : të lartë, të mesëm dhe të ulët.

- Subjekte me rrisik të nivelit të lartë konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike mbi bazën e Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave të fituara si rezultat i një procedure konkurrimi publik,

si dhe sipërmarrësi që ka trashëguar rrjetin e operatorit ish *incumbent* të telefonisë fikse në vend;

- Subjekte me rrisht të nivelit të mesëm konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike: telefoni fikse, akses në internet, broadband, etj., me shtrirje gjeografike në tërë territorin e vendit ose që kanë një numër përdoruesish aktivë mbi 800 pajtimtarë;
- Subjekte me rrisht të nivelit ulët konsiderohen sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike: fikse, akses në internet, broadband, etj., me shtrirje gjeografike të ngushtë ose që kanë një numër përdoruesish aktivë deri në 800 pajtimtarë.

Në përfundim të vlerësimit të rrishtit, DMFCI ne bashkëpunim me drejtorite e tjera të AKEP, rezultatet e përfutuara i nxjerr në Raportin e Vlerësimit të Rrishtit (RVR) duke i pasqyruar ato në Tabelën e vlerësimit të rrishtit për qëllim të Planifikimit Strategjik dhe vjetor sipas shembullit të Formatit Standard të parashikuar në MPI.

Përcaktimi i tematikave të inspektimit për Planifikimin Strategjik dhe atë vjetor, bëhet mbi bazën e rrishtit të vlerësuar sipas RVR.

Objektivi është që çdo sipërmarrës, i regjistruar në *database* të inspektohet minimalisht jo më pak se 1 (nje) here brenda 2 (dy) viteve.

2.3.2 Vlerësimi i rrishtit gjatë inspektimit

Vlerësimi i rrishtit gjatë procesit të inspektimit kryhet nga inspektorë/t dhe ekspertet në përbërje të grupit të inspektimit. Metodika e analizës së rrishtit është e njëjtë me atë të analizës së rrishtit gjatë planifikimit Strategjik dhe vjetor duke e zbatuar në mënyrë më të thelluar dhe të detajuar, në kushtet e ekzistencës së rrethanave faktike të subjektit që po inspektohet. Mbi bazën e rezultateve të analizës faktike të rrishtit vendosen edhe penalitetet kur shkeljet e vërtetuara përbëjnë kundërvajtje administrative të parashikuar në nenin 136 dhe nenin 137 të ligjit nr. 9918/2008.

Masa administrative ose gjoba për shkeljet e vërtetuara vendosen duke vlerësuar kriteret:

- Niveli i rrishtit të analizuar dhe pasojës si rrjedhojë e kundërvajtjes administrative të konsumuar;
- Statusit të sipërmarrësit në treg referuar shtrirjes territoriale dhe afatit të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë;
- Statusit të subjektit në raport me historikun e performancës së ofrimit të shërbimeve të autorizuara dhe rezultateve të inspektimeve të kryera më parë.

2.4 Plani vjetor i inspektimit

Plani vjetor i inspektimit hartohet nga DMFCI mbi bazën e planit strategjik të inspektimit. Ndryshe nga plani strategjik i inspektimit që paraqet një panoramë të punës që do të bëhet në tre vitet e ardhme, plani vjetor i inspektimit duhet të japi me shumë informacion mbi punën që do të kryjë AKEP gjatë një viti për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve. Plani strategjik i inspektimit përmbledh tregues të përgjithshëm, ndërsa ai vjetor është më i detajuar dhe bazohet më shumë mbi informacionin e vlerësimit të rrishtit.

Programimi vjetor i inspektimeve bëhet mbi bazë tematike dhe ka për qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit gjatë vitit.

Numri sasior i subjekteve për inspektim sipas planit vjetor përcaktohet duke i grupuar subjektet e inspektimit sipas:

- kategorizimit të nivelit të rrishtit;
- numrit të përgjithshëm të sipërmarrësve të regjistruar në *database*;
- territorit të ushtrimit të veprimtarisë;
- kohës së regjistrimit fillestar;
- përlllogaritjes së burimeve të inspektimit;

Kur inspektimi kryhet për herë të parë në një subjekt me nivel të lartë rrishtit, proceset e kryera prej tij rishikohen në detaje, me qëllim që të përcaktohen se cilat janë proceset kyçe dhe sat ë sigurta janë ato. Ndërkohë që inspektimet vijuese në një system me rrisht të lartë, puna inspektuese mund të kufizohet vetëm në verifikimin nëse proceset, rrishtet dhe kontrollot janë po ato që kanë qenë më parë dhe në këtë rast kryhen testet e pajtueshmërisë me rregullat kyçe.

Subjektet e inspektuara të cilat rezultojnë me probleme apo konsumim të veprave të kundravajtjeve administrative të parashikuara në nenin 136 dhe nenin 137 të ligjit nr. 9918/2008, në varësi të problemit dhe shkeljes së vërtetuar nga inspektori, programohen për inspektim jashtë planifikimit vjetor, brenda një afati që gjykohet i mjaftueshëm për rregullimin e problemit apo shkeljes së konsumuar.

AKEP merr në konsideratë faktorët e mësipërm në gjykimin prej tij se kur duhet të ndërmerret një inspektim dhe sa kohë duhet t'i kushtohet inspektimit. Për këtë AKEP përdor udhëzimet e parashikuara në MPI për këtë qëllim.

2.5 Afati i përgatitjes dhe miratimit të planit strategjik dhe planit vjetor

Plani Strategjik përgatitet nga DMFCI në bashkëpunim me drejtorite e tjera të AKEP, brenda muajit nëntor të çdo viti dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Brenda 15 diteve nga miratimi, i percillet Inspektoriati Qendror.

Plani vjetor i inspektimit hartohet nga DMFCI brenda muajit Dhjetor të çdo viti dhe miratohet nga Kryetari i KD të AKEP.

2.6 Planifikimi mujor i inspektimit

Planifikimi mujor bëhet i detajuar me subjekte të përzgjedhura për inspektime mujore sipas planit vjetor. Plani mujor i inspektimit i miratuar nga drejtori i DMFCI i paraqitet Titullarit të AKEP për konfirmim përpara datës 1(një) të çdo muaji. Kriteret bazë për përzgjedhjen e subjekteve që do të inspektohen gjatë muajit janë:

- Niveli i rrishtit sipas matricës vjetore të vlerësimit;
- Menaxhimi efektiv i burimeve të inspektimit.

Në bazë të planifikimit vjetor të numrit të inspektimeve që do të kryhen përzgjidhen subjektet që do të inspektohen në muajin përkatës, sipas kushteve të mëposhtme:

1. Përzgjedhja e rastit e subjekteve për kontroll sipas kriterëve të vendosura dhe listë verifikimit (sipas planifikimit vjetor);
2. Lista e subjekteve që kishte shkelje të rënda në kontrollet e mëparshme sipas listë verifikimit (keficient të lartë);
3. Subjektet që nuk janë inspektuar për një kohë të gjatë;
4. Lista e subjekteve për kontroll të jashtëzakonshëm (ngjarje, denoncim, etj.)

2.7 Planifikimi javor i inspektimit

Programi javor bëhet mbi bazën e subjekteve të inspektimit të planifikuar për muajin përkatës dhe ka për qëllim planifikimin e akteve të inspektimeve, përcaktimin e inspektorëve, datës dhe orës, kohëzgjatjes dhe objektit të inspektimit, për çdo subjekt inspektimi, gjatë javës. Plani javor i inspektimit bëhet nga inspektori i Planifikimit dhe Koordinimit të inspektimit në bashkëpunim me inspektorët Rajonalë dhe konfirmohet nga drejtori i DMFCI.

2.8 Grupi i inspektimit

Planifikimi i një inspektimi shoqërohet me përcaktimin njëkohësisht edhe të anëtarëve të stafit që do të jenë pjesë e grupit të inspektimit. Grupi i inspektimit minimalisht përbëhet nga 2(dy) anëtarë, njeri prej të cilëve në çdo rast duhet të jetë inspektor sipas emërtesës së strukturës dhe organikës së AKEP. Disa nga faktorët që merren në konsideratë për përcaktimin e stafit të grupit të inspektimit janë:

- Nëse ka ndonjë problem lidhur me pavarësinë e inspektorëve që i pengon ata të kryejnë një procedurë inspektimi në atë subjekt ose në atë fushë ku ushtron veprimtarinë subjekti;
- Madhësia dhe kompleksiteti i subjektit;
- Kompleksiteti dhe risku i subjektit/fushës që inspektohet;
- Eksperienca dhe numri i inspektorëve

Kur një subjekt që inspektohet është shumë kompleks, ose fusha që inspektohet është vlerësuar me risk të lartë, në grupin e inspektimit përfshihen inspektorë/ekspertë që kanë më shumë përvojë në punë.

Përbërja e stafit të grupit të inspektimit propozohet nga drejtori i DMFIC dhe miratohet nga Titullari i AKEP.

2.9 Ndarja e detyrave brenda anëtarëve të grupit të inspektimit

Është thelbësore dhe e detyrueshme që për çdo inspektor/ekspert në përbërje të grupit të inspektimit të përcaktohet detyra përkatëse që nga plani fillestar deri në lëshimin e procesverbalit dhe vendimit përfundimtar të inspektimit. Caktimi i detyrave për çdo anëtar të grupit të inspektimit bëhet duke marrë në konsideratë përvojën dhe aftësinë e stafit që do të kryejë inspektimin. Kjo siguron që stafi më i specializuar të angazhohet në fushta më komplekse të punës dhe ato me risk më të lartë.

Caktimi i detyrave për anëtarët e grupit të inspektimit bëhet nga përgjegjësi i të sektorit të planifikimit dhe koordinimit të monitorimit dhe inspektimit.

2.10 Kohëzgjatja (afatet kohore) dhe masat për sigurimin e cilësisë

Planet e inspektimit përveç elementëve bazë të tij si tematika/objekti i inspektimit, lista e subjekteve që do të inspektohen, matrica e riskut dhe burimet e inspektimit, duhet të përmbajë edhe kohëzgjatjen e inspektimit si dhe masat për sigurimin e cilësisë së tij. Plani i inspektimit hartohet në përputhje me udhëzimet dhe shembujt sipas MPI për këtë qëllim.

KAPITULLI III

RREGULLA TË PËRGJITHSHME TË AUTORIZIMIT DHE PROCESIT TË INSPEKTIMIT

3.1 Procedura e inspektimit

Inspektimi zbatohet mbi bazën e një procedimi administrativ të rregulluar nga ligji nr. 9918/2008, Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji për inspektimin.

Formatet standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit që përdoren nga AKEP janë të përshtatur sipas dokumenteve standard të përcaktuara në MPI dhe gjenden në Aneksin 1 të këtij Akti.

Këto formate janë si më poshtë:

- Autorizim inspektimi
- Procesverbal inspektimi
- Procesverbal inspektimi (i posaçëm)
- Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjentë
- Vendimi përfundimtar i inspektimit
- Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë
- Autorizim për zëvendësim inspektori
- Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektimit
- Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit
- Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit
- Vendim i komisionit (Këshillit Drejtues) të ankimit
- Ankesë për vendimin përfundimtar
- Ankim i veçantë

3.1.1 Gjenerimi i Autorizimit dhe njoftimi i tij te subjekti i inspektimit

Inspektimi i një subjekti autorizohet, si rregull, në bazë të programit të inspektimit mujor i cili hartohet dhe miratohet sipas këtij Akti. Përgjithësisht, një inspektim mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit, sipas rasteve të parashikuara në ligjin e veçantë.

Rregullisht, me nxjerrjen e autorizimit të inspektimit, subjekti, jo më vonë se 5 (pesë) ditë, njoftohet paraprakisht nga kryetari i grupit të inspektimit, nëpërmjet një mesazhi elektronik (email) për inspektimin që do të kryhet duke i dërguar edhe një kopje të skanuar të autorizimit. Por, inspektimi pas nxjerrjes së autorizimit mund të kryhet edhe pa e njoftuar paraprakisht subjektin, kjo në varësi të objektit të inspektimit, matricës së riskut dhe rrethanave të faktit. Njoftimi paraprak nuk kryhet kur:

- Ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;
- Mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
- Për inspektimin për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar;
- Konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkesë ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit;
- Inspektohet për rastin e ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve, që kanë çënuar apo mund të çënojnë jetën e shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin;
- Për inspektim rastësor.

Titullari i AKEP përcakton në autorizim nëse subjekti do të njoftohet ose jo paraprakisht.

3.1.2 Veprimet e grupit të inspektimit

Grupi i inspektimit, në datën e përcaktuar në autorizim, paraqitet në ambjentet e subjektit dhe dorëzon autorizimin, listën e kontrollit, si dhe paraqet kartat e inspektorëve të cilët do të kryejnë inspektimin. Pavarësisht nga njoftimi paraprak ose jo i autorizimit, në çdo rast, inspektori përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit dhe për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve dhe në vazhdim metodën e inspektimit e afatet për përfundimin e inspektimit.

Inspektorët kanë të drejtë që kryejnë veprimtari inspektuese vetëm në territorin e juridiksionit të AKEP. Inspektorët e sektorëve Rajonalë mund të kryejnë inspektime në kuadër të një sektori tjetër rajonal vetëm me Urdhër të posaçëm të Titullarit të AKEP.

Autorizimi i inspektimit shoqërohet me listën e kontrollit që do të ushtrohet nga grupi i inspektimit. Lista e kontrollit i përmbahet objektit të inspektimit dhe konsiston sipas rastit në verifikimin e plotë ose të pjeshëm të:

- Dokumentacionit ligjor të subjektit dhe autorizimet që disponon të lëshuara nga AKEP;
- Dokumentacionit që vërteton shlyerjen e detyrimeve të pagesave të subjektit për AKEP dhe tarifën e radikomunikacionit;
- Dokumentacionit që vërteton plotësimin e kushteve të përgjithshme sipas Autorizimit të Përgjithshëm dhe kushteve të veçanta sipas autorizimeve individuale për përdorimin e burimeve të fundme dhe akteve të nxjerra nga AKEP;
- Zbatimit të skemës teknike dhe teknologjisë së njoftuar.
- Kapaciteteve për përdorim të përbashkët të faciliteteve dhe aseteve.
- Disponimit të lejeve dhe akteve të lëshuara nga autoritetet kompetente të parashikuara si detyrime për t'u zbatuar nga subjekti sipas ligjit nr. 9918/2008 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3.1.3 Pranimi i inspektorëve dhe përgjegjësitë e subjektit të inspektimit

Subjekti i përcaktuar në autorizimin e inspektimit, me marrjen e njoftimit të inspektimit, është i detyruar ligjorë dhe merr masat e duhura për t'u mundësuar inspektorëve realizimin e inspektimit.

Subjekti i inspektimit edhe në rastet e paraqitjes së inspektorëve pa njoftim paraprak, menjëherë pas paraqitjes nga grupi i inspektimit të autorizimit dhe kartave të inspektorëve, lejon kryerjen e inspektimit duke u angazhuar maksimalisht për të mundësuar kryerjen e veprimeve të inspektimit sipas kërkesave ligjshme të inspektorëve. Përfaqësuesi i subjektit është përgjegjës për vënien në dispozicion të inspektorëve të:

- dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar,
- ambjenteve teknologjike ku janë instaluar pajisjet,
- infrastrukturës së rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese,

si dhe për:

- bashkëpunimin dhe mos pengimin e kryerjes së veprimeve të inspektimit;
- dhënien e shpjegimeve të nevojshme.

Administratori/përfaqësuesi ligjor i subjektit ose personi i autorizuar prej tyre me shkrim sipas statutit të shoqërisë (subjektit të inspektimit), shoqëron inspektorët gjatë kryerjes së veprimeve, si dhe nënshkruan aktet e nxjerra nga inspektori.

Administratori/përfaqësuesi ligjor është përgjegjës për saktësinë e adresës së selisë së subjektit, vendeve dhe ambjenteve të tjera ku ushtron veprimtarinë dhe adresës elektronike të njoftuar në AKEP sipas regjimit të autorizimit të përgjithshëm. Në rast pa saktësie ose njoftimi të rremë të adresës, subjekti penalizohet në përputhje me përcaktimet ligjore.

Mos lejimi i inspektimit dhe krijimi i pengesave të qëllimshme për kryerjen e inspektimit përbëjnë kundërvajtje administrative dhe është i dënueshëm sipas përcaktimeve ligjore.

3.1.4 Kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve

Pjesë e procedurës së zbatimit të inspektimit është edhe kontrolli në distancë i veprimtarisë së subjekteve (sipërmarrësve), i cili kryhet nga inspektorët/ekspertët e AKEP duke e monitoruar atë nga ambjentet ku punojnë ose ku janë vendosur pajisjet monitoruese fikse ose të lëvizshme për monitorimin e përdorimit të frekuencave dhe treguesve të cilësisë së ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Monitorimi në distancë i veprimtarisë së subjekteve konsiston në:

- Kontrollin e veprimtarisë për të cilën subjektet janë të detyruar të depozitojnë në AKEP dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit;
- Kontrollin e plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm, zbatimin e të cilave është i mundur për të kontrolluar nëpërmjet ekzistencës së tyre publike ose zbatimit të aplikacioneve të ndryshme;
- Kontrollin e përdorimit të spektrit të frekuencave të alokuar sipas autorizimeve individuale të lëshuara nga AKEP sipas ligjit;
- Administrimin e ankesave të paraqitura nga përdoruesit dhe pajtimtarët e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- Administrimin e ankesave ose monitorimeve të kryera nga institucione të tjera shtetërore ose publike për fusha të caktuara dhe që kanë lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9918/2008 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Përcaktimi i procedurës sipas pikes 3.1.

Rezultatet e kontrollit në distancë iu vihen në dispozicion subjekteve nga AKEP të shoqëruar me provat e administruara, rekomandimet përkatëse me afate të përcaktuara, për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, si dhe me aktet administrative të aplikimit të masave administrative të mundshme të parashikuara në ligj për kundërvajtjet administrative duke zbatuar për këtë një procedurë në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

3.2 Procesi i gjetjeve të inspektimit

Inspektorët gjatë inspektimit kontrollojnë veprimtarinë subjektit vetëm për sa është përcaktuar në objektin e autorizimit të inspektimit dhe listën e kontrollit. Nëse gjatë inspektimit konstatohen shkelje ose parregullsi të cilat nuk janë parashikuar në objektin e autorizimit të inspektimit, inspektorët nëpërmjet drejtorit të DMFCI njoftojnë Titullarin e AKEP dhe kërkojnë zgjerim të objektit të inspektimit. Titullari i AKEP, në varësi të rrishtit dhe rrethanave faktike vendos për zgjerimin e objektit të autorizimit ose nxjerr një autorizim të ri duke caktuar një grup tjetër inspektimi. Grupi i inspektimit të njoftojë sërish subjektin inspektues, për cdo ndryshim në Autorizimin ekzistues.

Në përputhje me objektin e inspektimit, inspektorët/ekspertët në përbërje të grupit të inspektimit fillojnë kryerjen e veprimeve sipas detyrave të përcaktuara dhe listës së kontrollit duke evidentuar me shkrim konstatimet si dhe duke fotografuar objekte/pajisje etj., me

cilësinë e provës për shkeljen e konstatuar. Dokumentacioni, informacioni, përgjigjet e dhëna nga subjekti, veprimet që kryhen nga inspektori në kuadër të inspektimit si dhe çdo konstatim dhe provë tjetër që lidhet me inspektimin, evidenton në procesverbalin që inspektori mban për këtë qëllim.

AKEP garanton mbrojtjen dhe respektimin e të dhënave personale si dhe ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit përgjatë gjithë inspektimit.

3.3 Bllokimi i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre

Bllokimi i pajisjeve dhe ndalimi i funksionimit të tyre kryhet nga inspektorët e AKEP në rastet dhe sipas procedurës së përcaktuar në nenin 134 të ligjit nr. 9918/2008.

Administrimi i pajisjeve të sekuestruara zbatohet nga AKEP në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.

3.4 Procesverbali i inspektimit

Plotësimi i procesverbalit të inspektimit dhe raportimi i gjetjeve të aktivitetit të subjektit është një pjesë e rëndësishme e procesit të inspektimit. Përmes informimit mbi gjetjet e inspektimit, bëhen me dije përputhshmëria me kërkesat ligjore dhe janë baza për vendimin përfundimtar dhe rekomandimet për të përmirësuar zbatimin e kërkesave ligjore nga subjekti në të ardhmen.

Procesverbali i inspektimit si rregull plotësohet gjatë punës në terren nga përgjegjësi i grupit të inspektimit në bashkëpunim me inspektorët/ekspertët të cilët kryejnë inspektimin e subjektit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Inspektorët/ekspertët në përbërje të grupit të punës duhet të bien dakort për saktësinë e gjetjeve faktike të tyre, nga puna në terren.

Nëse përfundimi i procesverbalit në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e AKEP dhe njoftohet brenda 5(pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të inspektimit në subjekt. Me përfundimin e këtij afati, brenda 30 ditëve, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit. Procesverbali mbahet në tre kopje dhe nënshkruhet grupi i inspektimit. Në rast mosdakortësie, inspektori/eksperti që ka qëndrim të ndryshëm nga pjesa tjetër e grupit, bën me shkrim observacionin e tij duke arsyetuar dhe mbështetur gjetjen e tij në bazë ligjore dhe prova.

Në rastet kur inspektori, për arsye të justifikuar gjykon të mos jetë pjesë e një procesi inspektimi, ai ka të drejtë që me anë të një kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektimit, drejtuar Titullarit të AKEP, të kërkojë zëvendësimin e tij. Në arsyet e justifikuara përfshihen konflikti i interesit, programimi në një proces tjetër, paaftësi e përkohshme, etj.

E drejta e këtij zëvendësimi i takon Titullarit të AKEP, i cili në rast se gjykon që zëvendësimi duhet kryer plotëson autorizimin për zëvendësim inspektori.

Procesverbali fillon me evidentimin e të dhënave të përgjithshme :

- Të dhënat mbi subjektin;
- Saktësia e adresës së njoftuar;
- Njoftimi i inspektimit ose jo;
- Autorizimi i inspektimit së bashku me objektin e inspektimit dhe listën e kontrollit;
- Lejimi ose pengimi i inspektimit;

- Pjesmarrja apo përjashtimi i përfaqësuesit të autorizuar të subjektit duke regjistruar dhe arsyen e përjashtimit.

Me tej, në procesverbal grupi i inspektimit, në mënyrë kronologjike regjistron të gjithë punën që ka bërë, ku shënon të gjitha gjetjet në subjekt si dhe bën evidentimin e tërë dokumentacionit të verifikuar.

Në procesverbal evidentohen shkeljet e konstatuara, provat që vërtetojnë shkeljen, dokumentet e sekuestruara dhe pajisjet e bllokuara (nëse ka të tilla) etj, masat administrative të propozuara ose vendosura, komunikimi i të drejtave që disponon subjekti ligjrisht për ankim, si dhe detyrat dhe rekomandimet e lëna. Pjesë e pandarë e procesverbalit është edhe “Listë kontrolli”.

Në mbyllje bëhet formalizimi i procedurës duke nënshkruar inspektorët dhe subjekti. Subjekti është i detyruar të nënshkruajë në çdo rast procesverbalin.

Nëse subjekti nuk bie dakort me procesverbalin e nënshkruan atë “*me rezervë*” dhe i bashkëlidh procesverbalit aktin e tij të parashtrimit të kundërshtimeve. Procesverbalin i pa nënshkruar nga subjekti i inspektimit, i pa shoqëruar me shënimin “*nënshkrim me rezervë*” dhe aktin e parashtrimit të kundërshtimeve, konsiderohet i vlefshëm dhe ka të njejtën fuqi juridike si të jetë i nënshkruar rregullisht nga subjekti, kur provohet se subjekti është njoftuar mbi aktin e inspektimit psh. përmes dërgimit me postë sapo me email.

3.5 Masat urgjente

Inspektori gjatë inspektimit, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur:

- Për shkak të shkeljes së konstatuar ose kur ka një dyshim të arsyeshëm që për shkelje të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit public, është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo testeve.

Nëse është e mundur, qëllimi për të marrë një masë urgjente i njoftohet, paraprakisht, në mënyrë verbale, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, duke i dhene mundësinë për të paraqitur pa vonesë komentet dhe shpjegimet përkatëse.

Inspektori evidenton në procesverbalin e inspektimit edhe masat urgjente të marra për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore dhe të efektit të dëmshëm tmenjëhershëm që mund të vijë sigurisë publike. Në rast të marrjes së masave urgjente plotësohet Procesverbal (aty për aty) dhe Vendimi i ndërmjetëm të cilët kanë hapësirë për ngarkim dokumenti në procesverbalin e inspektimit.

Masat urgjente janë:

- Ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;
- Ndalimi i funksionimit të një instalimi rrjeti apo pajisje;
- Bllokimi i pajisjeve të pa autorizuara;
- Urdhëri i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme;
- Çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

3.5.1 Vendimi i ndërmjetëm

Vendimi i ndërmjetëm është me ekzekutim të menjëhershëm. Nëse nuk ekzekutohet vullnetarisht, pa vonesë nga subjekti i inspektimit apo nëse ai bën të ditur ose nga rrethanat rezulton se nuk do ta ekzekutojë vendimin, vendimi ekzekutohet menjëherë nga inspektori përkatës në përbërje të grupit të inspektimit, me shpenzimet e subjektit të inspektimit, të cilat pasqyrohen në vendimin përfundimtar apo në një akt të veçantë.

Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë tek Këshilli Drejtues i AKEP. Trajtimi i ankesës dhe hartimi i akteve për shqyrtim dhe miratim në KD bëhet nga komisioni *ad-hock* i trajtimit të ankesës i përbërë nga:

- Inspektori me më shumë përvojë në DMFCI i pa përfshirë në grupin e inspektimit që ka vendosur masën;
- Eksperti sipas drejtorisë përkatëse që mbulon objektin e veprimtarisë për të cilën është vendosur masa urgjente;
- Juristi që mbulon ankesat në DZMMK;

sipas afatit dhe procedurës së përcaktuar në Kodin e Procedura Administrative.

Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe nuk është parashikuar një afat i tillë, me:

- Njoftimin e revokimit të tij;
- Njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
- Skadimi i afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
- Njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;
- Skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrative ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;
- Urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale. Një akt i shkruar me të njejtën përmbajtje njoftohet brenda 24 orëve. Masat urgjente mund të merren deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.

3.6 Ankimi i veçantë

Pjesë e procedurave të ankimit administrative të inspektimit është edhe ankimi i veçantë, të cilin ka të drejtë ta bëjë subjekti i inspektimit gjatë procedurës së inspektimit, në rastet kur grupi i inspektimit ka marrë masë urgjente. Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë sipas Formatit “Ankim i veçantë” i cili mund të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe i drejtohet Keshillit Drejtues të AKEP.

Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë ose mos shqyrtimit të tij nga Keshilli Drejtues i AKEP, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3.7 Procesverbal inspektimi (I posaçëm)

Procesverbali i inspektimit (I posaçëm) plotësohet nga grupi i inspektimit në rastet e ngjarjeve të jashtëzakonshme dhe të inspektimeve të rastësishme, të cilat kanë të drejtë të kryejnë kur vërejnë shkelje të kërkesave ligjore të cilat përbëjnë rrezik për sigurinë publike.

Procesverbali i inspektimit (I posaçëm) tregon hapjen e një çështje të caktuar, sipas rasteve të sipërcituara, dhe fillimi i saj pasqyrohet, pa vonesë, me një shënim në një rubrikë të posaçme të procesverbalit të inspektimit dhe konsiderohet, si autorizim i posaçëm. Inspektori i planifikimit dhe koordinimit ose ai Rajonal detyrohet të njoftojë, pa vonesë, drejtorin e DMFCI për lëshimin e autorizimit të inspektimit nga Titullari i AKEP, për fillimin e çështjes dhe ky i fundit duhet të nxjerri Autorizimin për kryerjen e këtij inspektimi brenda 24 orëve nga fillimi i procedurës së inspektimit. Në rast se nuk lëshohet Autorizimi Brenda këtij afati, atëherë procesverbali i inspektimit (I posaçëm) nuk do të jetë i vlefshëm.

3.8 Vendimi përfundimtar

- a. Vendimi përfundimtar i inspektimit është akti që mbyll një procedurë inspektimi dhe nxirret nga grupi i inspektimit pas nënshkrimit të procesverbalit.
- b. Në rastet kur nuk janë konstatuar shkelje vendimi përfundimtar i inspektimit bashkëlidhet procesverbalit dhe i dorëzohet subjektit në vend.
- c. Në rastet kur janë konstatuar shkelje, grupi i inspektimit bazuar në procesverbalin e inspektimit dhe administrimin e shpjegimeve, provave dhe kundërshtimeve të dhëna nga subjekti i inspektimit, përpilon vendimin përfundimtar të inspektimit dhe brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit, ia dërgon atë subjektit të inspektimit duke përcaktuar edhe masat administrative.
- d. Në rastet kur shkeljet e konstatuara propozohen të penalizohen me masa administrative të propozuara nga grupi i inspektimit sipas ligjit nr. 9918/2008 për Këshillin Drejtues, me mbylljen e procesverbalit kërkesa i paraqitet Këshillit Drejtues për shqyrtim dhe miratim brenda 10(dhjetë) ditëve kalendarike nga njoftimi i procesverbalit. Këshilli Drejtues brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, shprehet me vendim mbi propozimin e grupit të inspektimit për masën administrative duke thirrur edhe subjektin e inspektuar dhe grupin e inspektimit në seancë dëgjimore përpara marrjes së vendimit.
- e. Këshilli Drejtues në përfundim, merr vendim të arsyetuar duke vendosur:
 - Miratimin e e propozimit të grupit të inspektimit ose,
 - Rrezimin e propozimit,ose,
 - Ndryshimin e masës administrative të propozuar.

Grupi i inspektimit, bazuar në vendimin e KD, vendos në vendimin përfundimtar të inspektimit, masën administrative të përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

3.9 Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit

Pas dhënies së vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtën e ankimit administrativ kundër gjobës së vendosur. Ankimi fillon me ploësimin e Formatit “Ankesë për vendimin përfundimtar” drejtuar Këshillit Drejtues të AKEP, në afatin 10 ditor nga dita kur subjekti i inspektimit ka marrë njoftim për Vendimin përfundimtar, ku përcaktohet edhe e drejta për të paraqitur ankimin pranë Këshillit Drejtues të AKEP për gjobën e vënë sipas pikës 1 të nenit 136 dhe nenit 137 të ligjit nr. 9918/2008 ose kundërvajtjet administrative sipas pikës 2.a),b) të nenit 135 të këtij ligji.

Paraqitja e ankimit pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por, paraqitja e ankimit nuk çënon ekzekutimin e masave urgjente të marra nga grupi i inspektimit gjatë procesit të inspektimit.

3.10 Vendimmarrja e Këshillit Drejtues

Me marrjen e ankimit, Kabineti i Kryetarit të KD vë në dijeni Këshillin Drejtues dhe ia përcjell atë së bashku me praktikën dokumentare shoqëruese, komisionit *ad-hock* të i përbërë nga:

- Inspektori me më shumë përvojë në DMFCI i pa përfshirë në grupin e inspektimit që ka vendosur masën;
- Eksperti sipas drejtorisë përkatëse që mbulon objektin e veprimtarisë për të cilën është vendosur masa urgjente;
- Juristi që mbulon ankesat në DZMMK.

Komisioni *ad-hock* trajton ankimin, brenda 10 diteve nga data e depozitimit, duke përpiluar opinionin e tij dhe aktet për shqyrtim në mbledhjen e KD. Këshilli Drejtues merr vendim brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit Këshilli Drejtues nxjerr një vendim përfundimtar sipas Formatit “Vendimi i Komisionit (Këshillit Drejtues) të ankimit” i cili i dërgohet subjektit për ekzekutimin e tij dhe njëkohësisht publikohet në portalin *e-inspektim* në faqen *web* të AKEP www.akep.al.

Kundër vendimit të Këshillit Drejtues subjekti i inspektuar ka të drejtë të paraqesi ankim në Gjykatë në përputhje me legjislacionin në fuqi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

3.11 Ekzekutimi i vendimit përfundimtar

Me përfundimin e procedurës së ankimit në përputhje me kodin e procedurave administrative dhe nxjerrjen e Vendimit të Komisionit (Këshillit Drejtues) të Ankimit, drejtori i DMFCI i përcjell drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Pagesave (DMFP), praktikën dokumentare sipas dosjes së hapur nga grupi i inspektimit, me qëllim vjeljen e gjobës nëpërmjet ekzekutimit vullnetar të detyrimit nga brenda një afati 30 ditor nga data e marrjes njoftim nga subjekti i inspektimit ose publikimit të kërkesës së ekzekutimit vullnetar në portalin *e-inspektim* në faqen *web* të AKEP www.akep.al.

Pas periudhës së ekzekutimit vullnetar, nëse subjekti nuk e zbaton ekzekutimin e vendimit, për ekzekutimin e vendimit përfundimtar bëhet kërkesë në gjykatë nga AKEP për kthimin e vendimit përfundimtar në “*Titull ekzekutiv*” dhe ekzekutohet nëpërmjet përmbarrimit. Në faqen *web* të AKEP, në portalin *e-inspektim* pasqyrohet kërkesa për titull ekzekutiv.

3.12 Korrigjimi dhe ndjekja e shkeljeve të lëna nga inspektimi

Kur është e nevojshme, dënimi administrative shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e kostatuara dhe për eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin (rekomandimet) me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohen në një fletë shoqëruese.

Drejtori i DMFCI harton procesin e ndjekjes së korrigjimeve të shkeljeve të konstatuara për të monitoruar dhe për të siguruar që detyrat e lëna janë zbatuar me efektivitet, për këtë planifikohen edhe inspektime për të kontrolluar përmbushjen e detyrave të lëna nga inspektimi mëparshëm. Afatet e kësaj forme inspektimi nu përfshihen në afatet e përgjithshme të vendosura për kohën maksimale të qëndreimit në një subject inspektimi për periudhën ushtrimore.

Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar nga inspektorët në fletë porosinë e lënë së bashku me vendimin përfundimtar të

inspektimit të mëparshëm dhe, nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

Për verifikimin e korigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri. Inspektimi i ndjekjes së korigjimit të shkeljeve të lëna nga inspektimi siguron se subjekti i inspektimit ka përfunduar punën për të cilën kanë qenë informuar nga vendimi përfundimtar dhe fletë porosia e inspektimit.

Megjithëse të gjitha detyrat e lëna nga grupi i inspektimit janë të rëndësishme, disa mund të jenë më të rëndësishme se të tjerat. Si rrjedhojë inspektorët duhet të përcaktojnë një nivel rëndësie për secilën detyrë dhe tre kriteret që duhet të përdoren për vlerësimin e tyre janë si më poshtë:

- **I lartë** – Kjo vlen për parregullsi të rëndësishme të konstatuara gjatë inspektimit dhe është një problem që duhet të adresohet menjëherë nga subjekti i inspektimit nga rrezikshmëri e lartë.
- **I mesëm** – Kjo vlen për një parregullsi të rëndësishme të konstatuar gjatë inspektimit. Një gjë e tillë duhet të adresohet menjëherë nga subjekti i inspektimit por jo nga rrezikshmëri e lartë.
- **I ulët** – kjo vlen kur janë identifikuar parregullsi të vogla (jot ë rëndësishme) gjatë inspektimit. Ndryshimet duhet të zbatohen me kalimin e kohës, por nuk janë primare që subjekti t'i adresojë ato menjëherë.

Shtrirja e ndjekjes së korigjimit të shkeljeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm varet nga:

- Risku i ndodhjes së ndonjë ngjarje të kundërt nëse nuk merren masat korigjuese;
- Rëndësis e dobësive të zbuluara;
- Shkalla ndaj realizimit të objektivave të subjektit për zbatimin e kërkesave ligjore;
- Kostoja dhe përpjekjet që duhen për përmirësimin e parregullsisë;
- Objekti i veprimit korigjues për të gjitha strukturat e subjektit;
- Afati kohor për zbatimin e ndryshimeve të kërkuara.

Procedura për ndjekjen e korigjimit të shkeljeve të lëna nga inspektimi përmban:

- Vlerësimin dhe verifikimin e përgjegjësive të subjektit;
- Sigurinë që subjekti përkatës është i përgjegjshëm për risqet nga shmangia e kërkesave ligjore.

3.13 Raportimi i ndjekjes së detyrave të lëna

Plani startegjik i inspektimit përcakton subjektet/fushat që do të shikohen gjatë tre viteve të ardhshme. Disa subjekte, apo fusha inspektimi mund të jenë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së inspektimit të AKEP dhe si rrjedhojë mund të shikohen çdo vit. Në këto raste, inspektorët duhet të përfshijnë progresin në zbatimin e detyrave të lëna në inspektimin e mëparshëm për atë subject apo fushë inspektimi. Inspektorët në vitin në vazhdim, duhet t'i kërkojnë subjektit të inspektimit raportime periodike, duke përcaktuar se çfarë progresi është bërë përsa i përket zbatimit të detyrave për korigjimin e shkeljeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

Inspektorët përmbledhin gjetjet qartë/saktë dhe i evidentojnë ato pjesë të caktuara të procesverbalit të inspektimit dhe duhet të tregohen të vëmendshëm si ndaj reagimeve të subjektit, ashtu dhe ndaj afatit për zbatimin e detyrave të lëna.

Të gjitha detyrat e lëna nga inspektorët në përfundim të procedurës së inspektimit duhet të jenë:

- Specifike për veprimet që duhet të ndërmerren subjekti i inspektimit;
- Të dobishme, praktike dhe të bazuar në vlerësimin e mundësisë së subjektit të inspektimit për t'i zbatuar ato;

- Të marrin në konsideratë edhe koston e zbatimit dhe nëse kostoja e zbatimit është e konsiderueshme, atëherë kjo duhet të raportohet.

3.14 Kriteret për vendosjen e Masave administrative

Kur shkeljet e vërtetuara nga grupi i inspektimit përbëjnë kundërvajtje administrative ato janë të dënueshme me gjobë ose masa administrative të përcaktuara në nenin 136 dhe nenin 137 të ligjit nr. 9918/2008. Inspektori për vendosjen ose propozimin e gjobës ose masat administrative, konsideron këto kritere:

- Rëndësinë e shkeljes së konsumuar referuar parashikimit ligjor dhe pasojës/dëmit që ka shkaktuar;
- Analizën e riskut;
- Statusin e subjektit nëse është ose jo përsëritës i shkeljes së evidentuar ose shkeljeve të tjera të gjetura nga inspektorët;
- Reagimin e subjektit ndaj korrigjimit të shkeljeve të lëna nga inspektime të mëparshme;

KAPITULLI IV RAPORTIMI DHE KOMUNIKIMI I INSPEKTIMIT

4.1 Komunikimi i inspektimit

Raportimi i të gjitha gjetjeve të inspektimit zbatohet pavarësisht natyrës dhe rëndësisë së gjetjeve. Ky është një parim i rëndësishëm.

Komunikimi i mirë është tipar thelbësor i një inspektimi të mirëorganizuar. Raportimi ndihmon në efikasitetin dhe efektivitetin e inspektimit, proces i cili kontribuon në përmirësimin e menaxhimit të riskut dhe kontrollit. Raportimi i inspektimit duhet të jetë:

- **I saktë:** Raportimi është i mbështetur nga evidenca të mjaftueshme inspektimi;
- **Objektiv:** Raportimi i përshtatshëm dhe në prespektivë;
Raportet duhet të jenë të paanshme dhe pa devijime.
- **I qartë:** Komunikimi ndjek një vijë logjike që nga evidentimi e deri tek konkluzionet
Dhe rekomandimet, duke përfshirë referenca për dokumentet përkatës;
Të shmangët përdorimi i termave teknike dhe zhargoni pa shpjegime të qarta;
Të jepet një ekspozitë e përshtatshme për problemet komplekse;
Të qartësohen çështjet komplekse duke përdorur diagram, grafikë apo mjete të tjera vizuale ndihmëse.
Të shmangen fjalitë e gjata që vështirësojnë kuptimin e qartë.
- **Konçiz:** Kur duhet raportuar informacion i konsiderueshëm të jepet një përmbledhje e pikave kyçe.
- **Në kohë:** Në kohën e duhur për të mundësuar veprime të shpejta korrigjuese;
Për gjetjet apo risqet kyçe, inspektorët mund të përdorin diskutime joformale ose komunikime të vazhdueshme për të parashikuar konsideratat dhe veprimet e menaxhimit.
- **Konstruktiv:** Me tonalitet të përshtatshëm dhe profesional;

Duhet të shmanget përmendja e emrave të individëve apo vënia në dukje e gabimeve të tyre; Të shmangen fjalitë që janë shumë të gjata për t'u kuptuar menjëherë; etj. (*Referohu MPI Kapitulli IV, pika 4.1*)

4.2 Struktura e raporteve të inspektimit

Struktura e raporteve të inspektimit në AKEP përmban titujt kryesorë:

- Përmbledhjen ekzekutive;
- Hyrjen;
- Metodën e inspektimit
- Gjetjet dhe konkluzionet;
- Rekomandimet.

4.3 Raportet periodike dhe raporti vjetor i inspektimit

Raportet e inspektimit përgatiten nga sektori i planifikimit dhe koordinimit të monitorimit dhe inspektimit dhe pasi konfirmohen nga drejtori i DMFCI përcillen në Kabinet për procedure. Kabineti pasi merr miratimin e Kryetarit e përcjell informacionin në Këshillin Drejtues të AKEP. Raportet janë periodike dhe vjetore. Raportet periodike janë mujore dhe gjashte mujore.

Raportet mujore shërbejnë për të pasqyruar punën e bërë dhe pritshmëritë, ndërsa raportet gjashte mujore dhe raporti vjetor pasqyrojnë në mënyrë analitike edhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave dhe detyrave për korrigjimin e shkeljeve.

Raporti vjetor duhet të jetë objektiv, i drejtë dhe të përfshijë të gjithë fushat e inspektimit në juridiksionin e AKEP. Format i tij duhet të përmbajë kryesisht:

- Titujt kryesorë dhe nëntitujt e duhur;
- Komentet për dokumentet e punës, si dhe raportet periodike;
- Shembujt për të mbështetur komentet e dhëna;
- Përmbledhjen, ku të jepet një përshkrim i shkurtër i aktivitetit inspektues të kryer;
- Rekomandime konstruktive dhe përmirësime të sugjeruara.
- Objektivat për vitin pasardhës.

DISPOZITA TE FUNDIT

1. Plani Strategjik 3 vjecar miratohet nga Këshilli Drejtues brenda 45 diteve nga miratimi i kësaj rregulloreje dhe përditësohet çdo vit, me qëllim që të sigurohet përshtatja e tij.


2. Tabela e vlerësimit të riskut do të përgatitet nga DMFCI në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AKEP, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të kësaj rregulloreje.

3. Rregullorja Nr.34, date 23.12.2014 për "*Inspektimin, Monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative*" shfuqizohet.


ANEKS A

KARTË INSPEKTORI

(Pjesa para)

	
<hr/> <small>REPUBLIKA E SHQIPËRISË</small>	
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE	
KARTË INSPEKTORI	
<div style="border: 1px solid black; width: 150px; height: 80px; margin: 0 auto; display: flex; align-items: center; justify-content: center;">Fotografi e inspektorit</div>	
Emri:
Mbiemri:
Pozicioni: (Inspektor/ekspert)
Spektori Rajonal:
Data e lëshimit: xx/xx/2016	

(Pjesa prapa)


<i>Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbje ose</i>

moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë AKEP

Kodi i Kartës _____

www.akep.al
info@akep.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AUTORIZIM INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Bazuar në nenin 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe nenin 27 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” autorizoj inspektimin e:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët shtetërorë të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar;

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po Jo

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: _____

K R Y E T A R I

Nënshkrimi, vula e institucionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PROCESVERBAL INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/PV

Datë _____.____.

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit:

(ora, data e fillimit) (ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Njoftim paraprak lënë subjektit : Po Jo

Inspektim me autorizim: Po Jo

(N.q.s. jo, do zgjidhet nga sistemi një nga gerrat e nenit 27, pika 2, të ligjit 10 443)

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po Jo

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po Jo

(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë arsyetimi sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit dhe të ketë hapësirë për ngarkim dokumenti shpenzimi)

Përfundimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit: Po Jo

(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë)

Arsyetimi i përfundimit:

Masa urgjente: Po Jo

(Nqs Po të plotësohet si më poshtë dhe

hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm në sistem)

II. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Mostra të marra:

Po Jo

(n.q.s. Po më poshtë do të gjenerohet nga sistemi tabelat e mëposhtme në varësi të Inspektoratit Shtetëror përkatës)

TABELA E MARRJES SË MOSTRAVE

TABELA (për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive)

2. Dokumente të marra:

Nr. DOKUMENTI I MARRË DHE PËRSHKRIMI

NR. FLETËVE

1 _____

2 _____

3. Vendim për sekuestrim dokumentacioni:

Nr. DOKUMENTI I SEKUESTRUAR DHE PËRSHKRIMI

NR. FLETËVE

1 _____

2 _____

4. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

5. Detyrimi i subjektit për paraqitje në zyrën e inspektorit

Po Jo

(Nenin 33, pikat 1/b dhe 2, të ligjit nr. 10 433, datë 16.06.2011 "Për inspektimin në RSH", si dhe parashikimit të ligjit _____)

Përfaqësuesi i autorizuar i subjektit _____, më datë _____; ora _____ të paraqitet në adresën: _____ për vazhdimin e procedurës së inspektimit.

6. Dokumentacioni dhe sendet që duhet të paraqesin:

Dokumente të paraqitura:

Nr. DOKUMENTI DHE PËRSHKRIMI

NR. I FLETËVE

1 _____

2 _____

Sende të paraqitura:

Nr. SENDI DHE PËRSHKRIMI

COPE

1 _____

2 _____

Mosparaqitja do të konsiderohet pengim në kryerjen e detyrës së Inspektorit Shtetëror referuar nenit 54, të ligjit 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në RSH".

7. Gjetjet e konstatuara

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Po

Jo

(N.q.s. Jo, ky procesverbal konsiderohet edhe si vendim përfundimtar)

(N.q.s. po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

8. Njoftimi i procesverbalit të subjektit të inspektimit

Për faktet dhe rrethanat e konstatuara të paraqitura në këtë procesverbal, subjekti mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet e tij me shkrim ose me gojë pranë inspektoratit shtetëror, brenda __ ditëve nga data e njoftimit të këtij procesverbali.

Me përfundimin e këtij afati, do të merret vendimi përfundimtar i inspektimit.

Bashkëlidhur listë verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.

III. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.____ datë___.____._____. nenit/eve _____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

a. _____;

b. _____;

2. Dënim administrativ plotësues:

a. _____;

b. _____;

c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korigjuar:

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë

Po

Jo

Nëse Po, vendimi përfundimtar ngarkohet në sistem.

Nëse Jo, vendimi përfundimtar kur nuk janë konstatuar shkelje ligjore, pasqyrohet më poshtë:

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën __.__.____ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti

Procesverbali i njoftohet subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PROCESVERBAL INSPEKTIMI (aty për aty)

Nr. III/00000007/PV

Datë __/__/____/

Bazuar në nenin 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

VI. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i punëdhënësit: _____

Masa urgjente:

10. Gjetjet e konstatuara në lidhje me masën urgjente

Ka shkelje të kërkesave ligjore:

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin/et e ligjit/ve:

11. Njoftimi i procesverbalit (aty për aty) subjektit të inspektimit

Faktet dhe rrethanat e konstatuara të njoftuara subjektit me qëllimin e marrjes së masës urgjente:

Subjekti i inspektimit mund të paraqesë shpjegimet apo kontestimet përkatëse:

VII. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën __.__._____ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët shtetëror

Personi i autorizuar nga subjekti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

PROCESVERBAL INSPEKTIMI
(I POSAÇËM)

Nr. III/00000007/PV

Datë ____.

Bazuar në nenin 132 e në vijim të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe nenin 45 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

VIII. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i punëdhënësit: _____

Kohëzgjatja e inspektimit në vendin e inspektimit: (gjenerohen nga sistemi, autorizimi)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektim me autorizim të posaçëm: Po Jo

Lloji i autorizimit: autorizim i afishuar: Po Jo

Hyrja dhe inspektimi forcërisht në prani të punonjësit të Policisë së Shtetit:

Po Jo

(N.q.s. Po, të plotësohet si më poshtë arsyetimi edhe sipas ligjit të posaçëm për policinë e shtetit, si dhe të ketë hapësirë për ngarkim të dokumentit të shpenzimeve)

Përfundimi i përfaqësuesit të subjektit të inspektimit: Po Jo

(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë)

Arsyetimi i përfundimit:

IX. PROCEDURA E INSPEKTIMIT

1. Gjetjet e konstatuara gjatë këtij inspektimi;

Ka shkelje të kërkesave ligjore: Po Jo

(N.q.s. Po të plotësohet si më poshtë)

Gjetjet e konstatuara në këtë procesverbal bien në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara nënenin/et e ligjit/ve :

2. Masa urgjente:

Po Jo

(N.q.s. Po, të plotësohet më poshtë dhe hapësirë për ngarkimin e vendimit të ndërmjetëm)

3. Detyra të parealizuara nga inspektimi i mëparshëm:

4. Shpjegime dhe kontestime të subjektit për faktet dhe rrethanat e konstatuara:

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, hartoi procesverbalin e inspektimit dhe ia njoftoi atë subjektit të inspektimit. Subjekti i inspektimit pati kontestimet si më poshtë vijon:

5. Shkelje të kërkesave ligjore:

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore *(emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës)*:

X. KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr.____ datë___.____.____ nenit/eve _____ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

3. Dënim administrativ kryesor:

c. _____;

d. _____;

4. Dënim administrativ plotësues:

d. _____;

e. _____;

f. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve. Bashkëlidhur dokumente që inspektori i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

XI. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

1. Vendimi përfundimtar në rastet e marrjes aty për aty, në përfundim të inspektimit (*sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm*)

XII. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën _____. dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

Inspektori/ët shtetëror

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Personi i autorizuar nga subjekti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**VENDIMI I NDËRMJETËM
PËR
MARRJEN E MASËS URGJENTE**

Nr. III/00000007/VN

Datë ____.

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Emri i punëdhënësit: _____

Në bazë të germës _____ të pikës 1 të nenit 43 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 32 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918), merret masa urgjente si më poshtë:

Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente:

_____ (ora, data e fillimit)

_____ (ora, data e përfundimit)

Shënim.

Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat I tillë, me:

- a) njoftimin e revokimit të tij;*
- b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;*
- c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;*
- ç) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;*
- d) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;*
- dh) urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.*

Inspektorët shtetëror të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

**Ky vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente njoftohet brenda 24 orëve.*

***Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij. Ankimi i veçantë paraqitet pranë degës territoriale të inspektoratit shtetëror përkatës.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

VENDIMI
PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____ . ____ . ____

Bazuar në nenin 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe nenin 46 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. _____, datë ____ . ____ . ____ , të zhvilluar në subjektin

prej datës ____ . ____ . ____ deri më datën ____ . ____ . ____ .

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë ____ . ____ . ____ dhe e njoftoi në datë ____ . ____ . ____ .

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore (*emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës të cilat merren nga procesverbali i inspektimit*):

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit/ve nr. ____ nenit/eve ____ pikës ____ germës ____ , ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

a. _____;

2. Dënim administrativ plotësues:

a. _____;

b. _____;

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. *Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive: (përzgjidhen nga sistemi)*

Inspektorët Shtetëror të autorizuar :

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti _____ ka të drejtën e ankimit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

VENDIM
PËR ZGJIDHJEN E ANKIMIT TË VEÇANTË

Nr. III/00000007/VP

Datë __.__.____

(Emërtimi)

Në bazë të nenit 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe pikes 2 të nenit 44 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimit të veçantë nr. _____, datë _____, I subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar),

Pasi shqyrtova ankesën e këtij subjekti dhe masën urgjente të marrë,

VENDOS:

1. Lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm dhe rrëzimin e ankimit të veçantë
2. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe pranimin e ankimit të veçantë
3. Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm, duke pranuar pjesërisht ankimin

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi (nëse zgjidhet opsioni 1)/ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2)/ ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse.

(Nënshkrimi, vula e institucionit)

Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**AUTORIZIM
PËR ZËVENDËSIM INSPEKTORI**

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Ndryshime në autorizimin nr. ____ datë _____.____._____:

Baza ligjore: neni 132 I Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe neni 30, pika 3, e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

Inspektori/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____
2. _____ ID: _____

Zëvendësohen me inspektorin/ët e autorizuar:

1. _____ ID: _____
2. _____ ID: _____

Persona të tjerë të autorizuar:

1. _____
2. _____

Zëvendësohen me:

1. _____
2. _____

K R Y E T A R I

Nënshkrimi, vula e institucionit

Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**KËRKESË PËR REFUZIM
TË AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë ____.

Drejtuar: z/znj. _____

Kërkesë për refuzim të autorizimit nr ____, datë _____

Bazuar në nenin 132 të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe pikën 3, të nenit 30, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet refuzimi i autorizimit nr. ____, datë ____, për arsye, si më poshtë:

1. Konflikt interesi
2. Programim në ...
3. Leje vjetore
4. Paaftësi e përkohshme
5. Etj.

INSPEKTORI

1. _____ ID: _____

Nënshkrimi, data



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**KËRKESË PËR SHTYRJE
TË AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Drejtuar: z/znj. _____

Kërkesë për shtyrje të autorizimit nr____, datë_____

Bazuar në nenin 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe pikën 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me: _____

(data e fillimit)

(data e përfundimit)

**Shënim: kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.*

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektorët shtetëror:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

VENDIM PËR SHTYRJE
TË AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/A

Datë _____.____._____

Bazuar në nenin 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe pikën 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe kërkesën nr____ datë____ autorizoj/nuk autorizoj shtyrjen e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: *(Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)*

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

1. _____ ID: _____

2. _____ ID: _____

(Nëse jepet autorizim për shtyrje të afatit)

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me _____

(data e fillimit) (data e përfundimit)

Shënim: Kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

K R Y E T A R I

Nënshkrimi, vula e institucionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

VENDIMI I
KOMISIONIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë _____.____._____

Emërtimi i komisionit të ankimit _____

Emri i subjektit që është ankuar të cilit i referohet vendimi përfundimtar.

Në bazë të nenit 132 e ne vijim të Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ankimit për vendimin përfundimtar nr._____, datë _____.____._____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar),

Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë (*Shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ*), komisionit i ankimit:

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar.
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar.
3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar.

Për sa më sipër urdhëroj lënien (nëse zgjidhet opsioni 1)/ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2) /ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse, (*gjenerohet nga sistemi masa e marrë*).

Nënshkrimi, vula e institucionit

Kundër vendimit të komisionit të ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANKESE
PËR VENDIMIN PËRFUNDIMTAR

Nr. III/00000007/VP
Drejtuar : Komisionit të ankimit

Datë ____ . ____ . ____

Subjekti ankues: _____

Objekti : Pavlefshmëri/ndryshimi i vendimit përfundimtar nr. ____ datë ____ . ____ . ____ (nr ____ datë ____ . ____ . ____ i vendimit përfundimtar që ankimohet).

Baza ligjore: neni 136 i Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe neni 51 i ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë (kjo pjesa plotësohet nga sistemi);

3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit _____

Nënshkrimi

Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ANKIMI I VEÇANTË

Nr. III/00000007/VP

Datë ___/___/___

Drejtuar: _____

Subjekti ankues: _____

Objekti: Pavlefshmëria/ndryshimi i vendimit të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente nr. ___ datë __. __. __. (nr datë i vendimit të ndërmjetëm që ankimohet).

Baza ligjore: Neni 136 i Ligjit Nr.9918, dat; 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji 9918) dhe neni 44 i ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë;

3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit : _____

Nënshkrimi

Ankimi i veçantë mund të paraqitet brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij.